



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MARRËVESHJE

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Nr. 9058 Prot, Datë 27.08.2024

POSTA SHQIPTARE SHA

Nr. 467 Prot, Datë 27.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË MARRËVESHJEN NR. 6092/1425. DT.
11.07.2023 “ PËR PAGESËN E PËRFITIMEVE NGA SIGURIMET SHOQËRORE DHE
ARKËTIMIN E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE
SHËNDETËSORE”**

“**Instituti i Sigurimeve Shoqërore**”, i krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 249, datë 05.06.1992 “Për krijimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, me seli në adresën: Rruga e Durrësit Nr. 83 Tiranë, Shqipëri, dhe me NIPT J726240021L, ligjërishit i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Astrit HADO (me poshtë referuar edhe si ISSH)

Dhe

“**Posta Shqiptare**” sh.a., person juridik i organizuar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me seli në adresën Rr. “Reshit Çollaku” Nr.4, Tiranë, e regjistruar pranë Regjistrat Tregtar në përputhje me vendimin Nr. 20718, datë 27.01.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT J61924007N, përfaqësuar nga Z. Ardit DEMIRI, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë (më poshtë referuar edhe si Posta)

Palët e mësipërme bien dakord për ndryshimin e marrëveshjes nr. 6092/1425 prot, datë 11.07.2023 “Për pagesën e përfitimeve nga sigurimet shoqërore dhe arkëtimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, si më poshtë:

Neni 1

Në paragrafin “Përkufizime”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“**“Sistem”** do të jetë tërësia e platformave elektronike që zoterojnë palët me qëllim përmbushjen e aktivitetit dhe veprimtarisë së tyre”.

2. Shtohet pika 11 me përmbajtjen si më poshtë:

““Ndërveprim” do të ketë kuptimin e shkëmbimit të informacionit dhe ekspozimit të dhënave të palëve sipas nevojës së realizimit të shërbimeve”.

Neni 2

Neni 1 ndryshohet me pëmbajtjen si më poshtë:

- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 i “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9001 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor që parashikon përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar
- Ligji nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”
- Ligji nr. 10325/2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”
- Ligji nr. 55/2020 “Për shërbimin e pagesave”
- Licenca nr. 46, datë 08.07.2020 dhe aneks Licenca 46/1 date 16/02/2024, e lëshuar nga Banka e Shqipërisë që autorizon Postën Shqiptare të ushtrojë aktivitetin si Institucion i Parasë Elektronike;
- VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare Sh.a. të shërbimeve postare, financiare, dhe shërbimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”, i ndryshuar;
- Vendimi i Bankës së Shqipërisë nr. 59 datë, 24.11.2021 “Për miratimin e rregullores për licensimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike si dhe regjistrimin e ofruesve të shërbimeve”.

Neni 3

Në fund të pikës 5.1 të nenit 5 shtohen fjalët si më poshtë:

“ose nga sistemi i pagesave të Postës Shqiptare sh.a. konform dispozitave ligjore në fuqi”

Neni 4

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 7.1 ndryshohet si më poshtë:



“Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. janë përgjegjës për mirëmbajtjen e portaleve të tyre respektive”.

2. Shtohet pika 7.18 me përmbajtjen si më poshtë:

“ISSH bie dakord dhe lejon aksesin e Postës Shqiptare sh.a. në informacionin që disponon i cili rezulton i nevojshëm për realizimin e objektit të marrëveshjes, sipas kushteve të parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”.

3. Shtohet pika 7.19 me përmbajtjen si më poshtë:

“ISSH dhe Posta Shqiptare sh.a. angazhohen në procesin e përditësimit të modaliteteve të ofrimit të shërbimit të identifikuar në objektin e kësaj marrëveshje sipas normave ligjore në fuqi”.

Neni 5

Pika 9.1 e nenit 9 ndryshohet si më poshtë:

“Sistemi Informatik do të punojë në intranetin e krijuar midis Postës Shqiptare sh.a. dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit. Sistemi nuk do të lejohet të aksesohet nga rrjeti publik në internet”.

Neni 6

Shtohet neni 15 me përmbajtjen si më poshtë:

“Dispozitë kalimtare

Pika 5.1 e nenit 5; 7.18 dhe 7.19 të nenit 7 dhe pika 9.1 e nenit 9 të kësaj marrëveshje do të hyjnë në fuqi vetëm pasi të jenë përditësuar dhe dakordësuar anekset teknike në lidhje me ndryshimin e modaliteteve të pagesës”.

INSTITUTI SIGURIMEVE SHOQËRORE

Përfaqësuar nga

Astrit HADO

POSTA SHQIPTARE SHA

Përfaqësuar nga

Ardit DEMIRI

1871-1872

1871